

Justinian Topulli

Në jetën tonë të përditshme ndeshemi pothuajse përditë me një mentalitet materialist në gjykimin e fisnikërisë ose jo të një pune a veprimi të dikujt. Nëse një punë, aktivitet apo qëndrim e konsiderojmë të gabuar e joparimor, shumë prej nesh në mënyrë gati instiktive do t'i atashojmë asaj lidhjen me paranë dhe interesin material dhe tokësor edhe pse mund të mos kemi asnjë fakt për ta provuar këtë.

Idealizmi për disa ose ka vdekur ose është e pamundur që ai të jetë pjesë, pak ose aspak, e motivimit të atij me të cilin nuk biem dakord dhe zakonisht nuk e njohim nga afër. Kështu që, për të delegjitimuar veprën, aktin, qëndrimin e punën e dikujt që e shohim të gabuar ose kundërshtar, mjafton të themi se ai paguhet dhe nga kush paguhet dhe kjo mjafton për ta denigruar kauzën e tij! Kësaj i thonë delegjitimim i kundërshtarit duke i mveshur atij një motivim materialist. Pra pa argumente dhe fakte që merren me vetë objektin e kundërshtuar, por me motivimin e supozuar të tij.

Kjo mendësi është e vjetër mes njerëzve, por këtu te ne (e gjetkë po ashtu) e ka kultivuar me tepri ideologjia marksiste, e cila bazën e shpjegimit të botës e kishte materialiste. Sipas komunistëve as Zoti dhe as bota tjetër nuk ekziston, kështu që veprimtaria njerëzore e motivuar për të përfituar hirin hyjnor dhe gjykuar favorshëm në botën e përtejme, ishte një farsë e kotë dhe si e tillë t'i besojë një "gënjeshtre" të tillë duhet të ishte ose naiv e injorant ose i metë, përndryshe duhet të ishte një rrufjan që për të përfituar materialisht do të shfrytëzoje injorancën dhe naivitetin e njerëzve, madje edhe do ta ushqejë atë në vazhdimësi. Ishte kjo një nga shpjegimet konstante materialiste që u ngulitej shqiptarëve në tru, për t'i shkëputur ata nga besimi në Zot dhe autoriteti fetar që predikonte fjalën e Tij. Dhe kjo për të vetmen arsye, sepse njerëzit për nga natyra e tyre janë të prirë t'i besojnë një idealisti, një të sinqerti, pavarësisht, sesa të saktë apo të gabuar e ka ai pikëpamjen e tij mbi botën.

Në mendësinë e njerëzve një njeri i sinqertë është edhe i drejtë në kauzën e tij, ndaj dhe i besojnë atij më shpejtë se kujtdo tjetër. Kështu që rruga më e lehtë dhe më e paargumentuara për të bindur masën naive është pikërisht delegjitimimi i kundërshtarit me akuzën se motivohet nga paratë, apo interesi material e tokësor edhe kur kjo nuk është aspak e vërtetë, sepse sipas fjalës "ku ka zë nuk është pa gjë" vetë akuza edhe 100 % e pasaktë mjafton për ta denigruar kundërshtarin në sytë e publikut.

Ky fenomen sot nuk ndodh vetëm me keqdashje dhe me dije, por edhe pa dashje dhe nga paragjykimi dhe vjen pikërisht nga mendësia dhe kultura materialiste me të cilën janë edukuar së paku dy breza në këtë vend, pasojat e së cilës vazhdojnë akoma në shoqërinë shqiptare dhe aspak nga objektiviteti i të parit të gjërave.

Për fat të keq, kjo mendësi instrumentale e të gjykuarit të gjërave, nëpërmjet motivimit të paragjykuar, përdoret edhe mes njerëzve që besojnë në Zot, të cilët e dinë se për besimtarin motivimi material në aktet parimore të tij ose nuk ekziston ose është dytësor. Jo se në mes

besimtarëve nuk ka njerëz të dobët që motivohen edhe nga paraja dhe interesa të tjera të kësaj bote, sepse edhe ata qenie prej mishi dhe kocke janë, por ta nisësh gjykimin tënd të paargumentuar për gabimin e dikujt mbi bazat të mentalitetit e motivimit materialist do të thotë se akoma nuk je shkëputur nga kultura marksiste e të vështuarit të gjërave edhe nëse pretendon se je besimtar në Zot.

Rruga e ndryshimit qenka e gjatë...

Zoti e mallkoftë komunizmin dhe gjithë farat e këqija që ai mbolli në këtë popull!